



Departamenti i Prokurimit

Prishtine : datë, 28.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.07.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “RAHOVICA COMERCE SHPK” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Implementimi i planit të mobilitetit-Rekonstruimi i rruges “Muharrem Fejza”, me Nr. të Prok: 616 19 6284 511 nxjerr:

V E N D I M

1.Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “Rahovica Commerce SHPK”e dates 25.08.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “ Implementimi i planit të mobilitetit-Rekonstruimi i rruges “Muharrem Fejza”, me Nr. të Prok: 616 19 6284 511 dhe vendoset si vijon:

2.Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit sipas Vendimit të dates 20.08.2020

3.Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “Rahovica Commerce SHPK” me datën 25.08.2020 ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Implementimi i planit të mobilitetit-Rekonstruimi i rruges “Muharrem Fejza”, me Nr. të Prok: 616 19 6284 511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 26.08.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

-Lidhur me pretendimin numer 1 se tenderuesi i propozuar për dhenje të kontratës sipas një ekspertize të mëparme ka qmimë jonormalisht të ulta ju sqarojme se rekomanimet e ekspertit nuk janë obligative për AK-ne,por konstatimet dhe rekomandimet e Panelit Shqyrtues të OSHP-se, respektivisht të Vendimeve të tyre.Poashtu besoj e dini se formula nga rregulla për

tenderet jonormalisht te ulet vlen kryesisht per qmimet totale te tenderueseve,ndersa krahasimin e qmimeve per njesi AK-ja e ben kur konsideron se ka arsye tjera per jobesueshmerine e tenderit atehere kerkon sqarime dhe ne rastin konkret ka konstatuar se nuk ka arsye te tilla.

-Ne citimet qe i keni bere nga Vendimi i OSHP-se shihet qarte se keni provuar qe te njejtat te jene ne favorin tuaj,por dy konstatimet me te rendesishme nga i njejt i keni anashkaluar,e qe jane:

-Ne konstatimin lidhur me deshmite e ofruara nga ankuesi paraprak "Alfa I" per makinën sperkatëse per emulsion është rekomanduar si vijon:

"Paneli shqyrtues konstaton se OE-ik ankues nepermes emailave qe ia ka derguar edhe perfaqesueseve te AK-se ka prezentuar deshmi se kjo paisje është derguar ne RMV dhe prap është kthyer ne Republikën e Kosoves,por AK nese ka dyshime lidhur me keto deshmi gjate rivleresimit mundet te kerkoj sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se."AK-ja ne fazen e rivleresimit e ka shqyrtuar deshmite shtese lidhur me kthimin e mjetit ne Kosove dhe ka konstatuar se ajo deshmi e vertetuar edhe nga Dogana e Kosoves është plotesisht e pranueshme siqe është edhe rekomandimi i cekur nga Vendimi i Panelit Shqyrtues dhe nuk ka nevojë te kerkohen sqarime plotesuse,pasi qe deshmia është e qarte;

-Rekomandimi tjetër qe ka te bëjë me plotesimin e kerkesave teknike profesionale te tenderit tuaj është si vijon:"Lidhur me pretendimin e OE-ik ankues "Alfa I"SHPK-Lipjan se sipas kerkeses te dosjes se tenderit ka qene te paraqiten dy teknik te ndertimtarise ndersa OE-ik "Rahovica Commerce"SHPK i rekomanduar me kontrate ka paraqitur dy inxhinier te ndertimtarise(z.Basret Selimi&z.Kadri Berisha),mirepo nuk është permbushur kerkesa e e AK-se ne kete rast sepse punet e teknikeve te ndertimtarise duhet t;i kryej tekniku e jo inxhinieri,,sepse kerkesa tjetër ka qene per inxhinier,pra jane kerkuar vecante inxhinier e veqante teknik te ndertimtarise.Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional te prokurimit konstaton se OE-ik"Rahovica Commerce SHPK"ne dokumentacionin e dorezuar me oferte dhe kerkesave te kerkuara ne FDT-ne e dosjes se tenderit te kriteret e kerkuara pika III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional ,ku kerkohet qe OE-ik duhet te angazhoj personelin profesional te cilet duhet te kene kualifikimet shkollore te meposhtme :-Dy teknik te ndertimtarise me dy vite pervoje pune pas diplomimit.Gjithashtu Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional te prokurimit vlereson se kjo pike e ankeses është e qendrushme sepse OE-ik "Rahovica Commerce"SHPK ne dokumentacionin e ofruar me oferte per 2 teknik te ndertimtarise ka ofruar dokumentacionin per dy inxhinier te diplomuar te ndertimtarise ,andaj OE-ik "Rahovica Commerce SHPK"me oferterten e tij nuk ka dorezuar dokumentacionin e kerkuar,pra nuk ka plotesuar kerkesat e kerkuara sipas FDT-se te dosjes se tenderit dhe siq është kerkuar pasi qe ky kriter ka mundur te ndikoj qe shume OE-ik te mos dorezojne ofertat e tyre sepse ne stafin e tyre nuk kane pase teknik te ndertimtarise dhe nuk e kane menduar se me kuader tjetër(inxhinier)munden me e plotesua kete kriter te kerkuar ne piken III.2.4.Kapaciteti teknik dhe profesional me FDT ne dosjen e tenderit.Andaj pretendimi i OE-ik ankues është i bazuar."

Nga konstatimi paraprak i Panelit Shqyrtues është e qarte se tenderi juaj nuk i ploteson kerkesat teknike dhe profesionale dhe qfaredo sqarimi qe do te kerkohej nga ju lidhur me pikat tjera nuk do ta bente tenderin tuaj te pergjegjshem.

Nga konstatimet paraprake eshte e qarte se AK-ja ne rivleresim ka respektuar te gjitha rekomandimet e Vendimit te Panelit Shqyrtues numer 261/20 dhe se pretendimet tuaja jane ne kundershtrim me te njejtat dhe si te tilla plotesisht te pa bazuara.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më larte ka vendosur si ne dispozitiv.

Keshille juridike:Pala e pa kenaqur me kete Vendim mund te parashtroje ankese ne OSHP ne afat prej 10(dhjete)diteve nga data e pranimit te te njejtit.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit